

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “SIGURIA E DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.40/2012”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012.

Objektivat kryesorë të projektit “Siguria e digave”, në kuadrin e programit për komunitetin e energjisë së Evropës Juglindore, janë:

- rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;
- rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve, por ky program u përgjigjet prioriteteve dhe qëllimeve të vëna për zhvillimin ekonomik të vendit dhe gjithashtu është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin e Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet letërmarrëveshjes ndryshuese synohet, si më poshtë vijon:

- Rishpërndarja e fondeve, me qëllim financimin e konsulencës teknike për supervizionin e punimeve shtesë të rehabilitimit elektromekanik dhe sistemit të kontroll-monitorimit të HEC-it Koman.

Aktivitetet në kuadër të projektit “Siguria e digave” kanë natyrë specifike. Plani i disbursimeve për këto aktivitete përgatitet mbi bazën e të dhënave, saktësia e të cilave është e limituar në fazën e përgatitjes së projektit dhe kontraktimit të aktiviteteve. Natyra dhe thellësia e punimeve rehabilituese elektromekanike (riparim apo zëvendësim pajisjesh/komponentësh), si dhe planifikimi i aktiviteteve dhe disbursimeve përkatëse varen thellësisht nga niveli i dëmtimit të hidroagregatëve, i cili mësohet vetëm pas demontimit të tyre. Pas demontimeve të tri agregateve/turbinave të para (Ag nr.2, Ag nr.3 dhe Ag nr.1) dhe miratimeve përkatëse të raporteve të demontimit dolën punime shtesë të paparashikuara në kontratë dhe të domosdoshme për t’u kryer.

Këto punime kërkojnë kohë dhe fonde shtesë. Vlerat e këtyre punimeve shtesë tashmë kanë kaluar limitin e angazhimit fillestar kontraktual dhe, për këtë arsye, propozohet rishpërndarja e fondeve. Fondet e propozuara për rishpërndarje janë të paangazhuara nën kategorinë 4. Në këtë mënyrë nuk cenohet asnjë aktivitet i planifikuar sipas marrëveshjes së kredisë së sipërcituar. Fonde të lira në kategorinë 4, në shumën 461.250 euro, propozohet të kalohen në kategorinë 1, “Mallra dhe punime”, për punimet shtesë në rehabilitimin elektromekanik të HEC-it Koman.

- Shtyrja e datës së mbylljes deri më 30.12.2020.
Punimet shtesë të sipërcituara do të kërkojnë kohën për zbatimin e tyre dhe, në këtë kuadër, grafikët e zbatimit do të kërkojnë shtyrjen e datës së mbylljes së kredisë deri më 31.12.2020.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë, në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është miratuar, në parim, me vendimin nr.608, datë 17.10.2018, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012. Teksti i propozuar përfaqëson komunikimin e Bankës Botërore, e cila njofton që, në mënyrë unilaterale, rishpërndan fondet nga kategoria 4 e projektit, në kategorinë 1 të projektit (skeduli 2, seksioni 4).

Gjithashtu, parashikohet të ndryshohet edhe data e mbylljes, e cila do të shtyhet deri më 31.12.2020 (seksioni IV.B.2).

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, e cila është përgjegjëse për zbatimin e programit në tërësi, dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe KESH, sh.a., ndërsa dokumenti i ndryshimit është përcjellë në mënyrë unilaterale nga Banka Botërore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH, sh.a., për periudhën 2018-2020.

KËSHILLI I MINISTRAVE